6. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e gjashtë 2017 Sipërfaqe - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë **(1,179)** personave fizik, përfshirë emrin dhe

mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

7. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e shtatë 2017 Sipërfaqe - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të tetëqind e tetëdhjetë e pesë (**885**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

8. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e parë 2017 Blegtori - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të dymijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë (**2,979**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

9. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e dytë 2017 Blegtori - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të dymijë e pesëqind e dyzet e gjashtë (**2,546**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

10. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e tretë 2017 Blegtori - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëmijë e treqind e njëzet e katër (**1,324**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

11. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e katërt 2017 Blegtori - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e dymbëdhjetë (**712**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

12. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e pestë 2017 Blegtori - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të gjashtëqind e dymbëdhjetë (**612**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

13. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Pagesa e gjashtë 2017 Blegtori - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë (**1,156**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

14. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM1 2017 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat

personale të pesëqind e nëntëdhjetë e tetë (**598**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

- Kolona e cila i përket vitit **2018**, përmban tetëmbëdhjetë (18) lista, që përmbajnë të dhëna personale të personave fizik (fermerëve). Listat e publikuara në kolonën e vitit 2018, të cilat përmbajnë të dhëna personale të personave fizik janë :

1. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM1 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë (**768**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

2. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM2 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë (**765**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

3. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM3 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e katërdhjetë e dy (**742**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

4. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM4 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e katërdhjetë e dy (**742**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

5. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëmbëdhjetëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë (**11,276**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

6. Lista e dytë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të katërmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (**4,866**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

7. Lista e tretë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të tremijë e nëntëdhjetë e tetë (**3,098**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

8. Lista e katërt e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e tetëdhjetë e një (**781**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

9. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një (**5,991**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

10. Lista e dytë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të dy mijë e dyqind e katër (**2,204**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

11. Lista e tretë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të dy mijë e treqind (**2,300**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

12. Lista e katërt e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2018 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të katërqind e shtatëdhjetë e pesë (**475**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

13. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM2 shtesë, 2017 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëqind e shtatëdhjetë e pesë (**175**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

14. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM3 2017 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy (**692**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

15. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë TM4 2017 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e pesëmbëdhjetë (**715**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shumën e përfituar.

16. Lista e tetë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2017 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të gjashtëdhjetë e shtatë **(67)** personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

17. Lista e shtatë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2017 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të tetëqind e nëntëdhjetë **(890)** personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

18. Lista e tetë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2017 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të nëntëdhjetë e tetë **(98)** personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

- Kolona e cila i përket vitit **2019**, përmban tetëmbëdhjetë (18) lista, që përmbajnë të dhëna personale të personave fizik (fermerëve). Listat e publikuara në kolonën e vitit 2019, të cilat përmbajnë të dhëna personale të personave fizik janë :

1. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të katërmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre **(4,153)** personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

2. Lista e dytë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të dymijë e nëntëqind e dyzet e tetë **(2,948)** personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

3. Lista e tretë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të tetëqind e shtatëdhjetë e dy **(872)** personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

4. Lista e katërt e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e një **(701)** personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

5. Lista e pestë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe

Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre (**1,663**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

6. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të dhjetëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë (**10,916**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

7. Lista e dytë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të katërmijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë (**4,376**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

8. Lista e tretë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëqind e njëzet e tetë (**128**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

9. Lista e katërt e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të tetëqind e tridhjetë e katër (**834**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

10. Lista e pestë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë (**769**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

11. Lista e pestë e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një (**1,681**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

12. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë, Therrje të kafshëve dhe Akuakulturë 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna, Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të tetëqind e dhjetë (**810**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

13. Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Qumësht sipas cilësisë, gjashtëmujori i dytë 2019 - formati PDF, e cila përmban një tabelë me pesë (5) kolona – Nr., Emri dhe Mbiemri, Komuna,

Nr. i letërnjoftimit dhe Shuma. Në këtë tabelë sipas numrit rendor gjenden të publikuara të dhënat personale të tetëqind e trembëdhjetë (**813**) personave fizik, përfshirë emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave (fermerit), komuna prej nga vjen, numrin personal dhe shuma e përfituar.

Ndërsa, kolona e cila i përket vitit **2020**, përmban 2 lista, Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Blegtori – Fizik 2020 PRE dhe Lista e fermerëve përfitues për Pagesa Direkte – Sipërfaqe – Fizik 2020 PRE. Në të dy këto lista, të dhënat personale që janë të publikuara janë: emri, mbiemri dhe komuna, ndërsa numri personal si një e dhënë personale nuk është publikuar.

Agjencia, më datë 10.02.2022, përmes postës elektronike, ka kërkuar nga Zyrtarë përgjegjës të AZHB-së, për të sqaruar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, ligjshmërinë e publikimit të listave të përfituesve si dhe nëse është paraparë marrja e pëlqimit nga subjektet e të dhënave.

Më datë 14.02.2022, përmes postës elektronike Agjencia është njoftuar lidhur me kërkesën e bërë për sqarime. Zyrtarët përgjegjës të AZHB-së ka sqaruar se baza ligjore për përpunimin e të dhënave të personave fizik (fermerëve) është nenit 8 paragrafi 2 i Ligjit Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/16 Tetor 2012); neni 15 paragrafi 7 i Ligjit Nr.07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 (Gazeta Zyrtare Nr.1/06 Janar 2021); Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.07/2021 Për Pagesa Direkte në Bujqësi për Vitin 2021, të datës 31.08.2021; Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.10/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-Nr.07/2021 për Pagesat Direkte në Bujqësi për Vitin 2021, të datës 23/11/2021; Udhëzim Administrativ (MBPZHR) – Nr.08/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)- Nr.02/2020 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2020-2021, të datës 29/10/2021.

Ndërsa, publikimi i listave të përfituesve është parapara me nenin 13, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i cili përcakton se: *“për të siguruar transparencë të mjaftueshme, kriteret përkrahëse publikohen në media dhe në Web faqen e Ministrisë”* dhe paragrafi 7 i po këtij neni, përcakton se: *“Agjencia për çdo vit publikon listën e përfituesve, **emrin , masën dhe shumën e dhënë përfituesit**”*.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP) përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.) të LMDHP-së, me **të dhëna personale** nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi i të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, Ligji në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LMDHP-së, përcakton se me **përpunim** nënkuptojmë “*çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi*”. Bazuar në këtë, mbledhja, por edhe publikimi i të dhënave personale hyn në kategorinë e përpunimit të të dhënave personale dhe si i tillë duhet të jetë i ligjshëm.

LMDHP, në nenin 4 ka përcaktuar parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i saktësisë, parimi i kufizimit të ruajtjes, parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit dhe në fund parimi i llogaridhënies, i cili përcakton se kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatoj përputhshmërinë e të gjitha e të gjitha parimeve të përcaktuara si më lartë.

Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës përcakton se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Parimi i ligjshmërisë, është një parim i rëndësie të veçantë për çështjen e bazës ligjore, pasi është një nga përbërësit kryesorë të nevojshëm që përpunimi të jetë i ligjshëm. Transparenca, nënkupton se kontrolluesi duhet gjithashtu t'u ofrojë subjekteve të të dhënave personale informacion të qartë dhe transparent në lidhje me qëllimin ose qëllimet e përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe bazën ligjore për ta bërë këtë. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDHP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale është e lidhur ngushtë me qëllimin e përpunimit, dhe kështu parimi i kufizimit të qëllimit luan një rol të rëndësishëm për të siguruar që përpunimi të ketë një bazë ligjore të vlefshme. Të dhënat personale duhet të mbledhen vetëm për qëllime të specifikuar, të qarta dhe legjitime dhe të mos përpunohen më tej në një mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime. Në veçanti, qëllimet specifike për të cilat të dhënat personale përpunohen, duhet të jenë të qarta dhe legjitime dhe të përcaktuara në kohën e mbledhjes së të dhënave personale. Ashtu si me parimin e kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e saktë të përpunimit që justifikohet nga një bazë e caktuar ligjore, si dhe çështja e “domosdoshmërisë”, e cila është një element kyç i shumicës së bazave ligjore. Përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë adekuat, relevant dhe i kufizuar në atë që është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato përpunohen. Të dhënat personale që përpunohen përtej këtyre kufijve, mund të mos ketë një bazë ligjore të vlefshme.

Si pjesë e minimizimit të të dhënave, kontrolluesi duhet të siguroj gjithashtu respektimin e parimit të kufizimit të ruajtjes, për të siguruar që të dhënat personale të mbahen vetëm në një formë që lejon

identifikimin e subjekteve të të dhënave për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat të dhënat personale përpunohen. Për të siguruar që të dhënat personale të mos mbahen më gjatë se sa është e nevojshme, kontrolluesi duhet të vendosë afate kohore për fshirje ose për një rishikim periodik.

AZHB, në cilësinë e kontrolluesit, publikimin e listave me përfitues të subvencioneve, e ka mbështetur në obligimin ligjor që ka pasur për publikimin listave sipas nenit 13, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i cili ka përcaktuar qartë se cilat të dhëna duhet të publikohen, e që janë **emri, masa dhe shuma e dhënë përfituesit**. Nga këndvështrimi i LMDHP-së, ligjshmëria e këtij publikimi të listave të përfituesve, me të dhënat të cekura më sipër, mbështetet në nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, i cili ka përcaktuar se përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi.

Bazuar në listat e publikuara gjatë viteve 2013 deri në vitin 2019, AZHB, përveç të dhënave personale për të cilat ka pasur bazë ligjore për publikim, e njëjta ka publikuar edhe të dhëna tjera siç është komuna prej nga janë përfituesit si dhe **numrin personal** të tyre.

Numri personal, si e dhënë personale, së bashku me emrin dhe mbiemrin, paraqet një shenjë individuale me të cilën shumë lehtë mund të identifikohet subjekti i të dhënave dhe i njëjti mund të përpunohet vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë të tij, apo është paraparë me ligj. Nëpërmjet numrit personal, në periudhën e digjitalizimit të shërbimeve, publikimi i tij (online) cenon rëndë privatësinë e subjektit të të dhënave dhe mund të ketë pasojë të rënda në jetën e tij. Për më tepër, për shkak të rëndësisë së tij, Agjencia konsideron se përpunimi i numrit personal duhet të bëhet vetëm sipas kushteve ligjore dhe kontrolluesi duhet të ketë kujdes të veçantë gjatë përpunimit.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, përmes publikimit të listave të fermerëve përfitues në faqen zyrtare të saj, lista këto që përmbajnë të dhëna personale, ku përveç emrit dhe mbiemrit, komunës, ashtu siç u tha më lartë, ka publikuar edhe **numri personal**, e njëjta me këtë veprim, ka cenuar privatësinë e subjektit të të dhënave, për arsye se ka ekspozuar/zbuluar një të dhënë unike të personit fizik në rrjet (internet), në të cilën kanë qasje numër i pakufizuar i vizitorëve. Për më tepër, publikimi i kësaj të dhëne (numrit personal) është në kundërshtim edhe me nenin 13, paragrafin 7 të Ligjit Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (LBZHR).

Për më tepër, LBZHR, në dispozitat e tij, nuk ka paraparë afatin se sa duhet të qëndrojnë të publikuara këto të lista dhe me këtë rast AZHB, ka qenë e obliguar që përveç parimeve tjera, të zbatoj edhe parimin e kufizimit të ruajtjes ashtu siç parashihet në nenin 4, paragrafin 5 të LMDHP-së, i cili përcakton se të dhënat personale mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në cilësinë e kontrolluesit, asnjëherë nuk ka pasur bazë ligjore të duhur që të bëjë përpunimin e të dhënave që nuk janë përcaktuar në LBZHR, sidomos përpunimin e numrit personal përmes publikimit, me këtë veprim ka përpunuar të dhëna personale në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të LMDHP-së dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 92, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas inspektimit të kryer dhe shqyrtimit të rastit, vërtetimit të gjendjes faktike, numrin e subjekteve të të dhënave të prekura nga ky përpunim i të dhënave personale, kohëzgjatjen e publikimit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 28.02.2022]

Zyrtari i Inspektimit
Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga data në të cilën është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë,
- Zyrës së Komisioneres,
- Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
- Arkivit të Agjencisë.